

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Korrik 2017

Tiranë, më 21 Gusht 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Korrik 2017 është 1.379.302. Krahasuar me Korrik 2016, ky tregues rezulton me rritje 2,8 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 864.023, krahasuar me Korrik 2016, ky numër është ulur me 0,1 %.

Numri i shtetasve të hyrë në vendin tonë në shtatëmujorin e 2017 është 5.199.145, duke u rritur me 5,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.


Në korrik 2017, ndër dhjetë vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, ato nga Zvicra kanë pësuar rritjen më të madhe me 52,3 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Kosova me 33,2 %. Në shtatëmujorin 2017, ndër dhjetë vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, rritja më e madhe e hyrjeve ka ardhur nga Polonia me 71,1 % dhe rënia më e madhe nga Kosova me 17,3 %. (shih tab 2.)

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Korrik 2017 janë 1.362.491, duke shënuar një rritje me 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Korrik 2017 është 496.163. Krahasuar me Korrik 2016, ky numër është rritur 11,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në shtatëmujorin e 2017 është 2.759.744 duke u rritur 4,9 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve të huaj në muajin korrik 2017, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 76,9 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 11,9 % dhe detare zënë 11,2 %. (shih tab. 4).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Për publikim 21/08/2017

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periodha	Korrik-16	Korrik-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Korrik 16	Janar-Korrik 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
Hyrje Gjithsej	1.342.336	1.379.302	2,8	4.924.726	5.199.145	5,6
Shqiptarë	477.618	515.279	7,9	2.459.313	2.575.828	4,7
Të Huaj	864.718	864.023	-0,1	2.465.413	2.623.317	6,4
Dalje Gjithsej	1.282.000	1.362.491	6,3	5.064.786	5.363.918	5,9
Shqiptarë	447.090	496.163	11,0	2.630.341	2.759.744	4,9
Të Huaj	834.910	866.328	3,8	2.434.445	2.604.174	7,0

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Korrik-16	Korrik-17	Ndryshim mujor në %	Janar-Korrik 16	Janar-Korrik 17	Ndryshim vjetor në %
Kosovë	444.471	297.040	-33,2	1.047.409	865.816	-17,3
Maqedoni	79.605	95.182	19,6	311.904	341.706	9,6
Greqi	42.624	45.721	7,3	232.916	245.906	5,6
Itali	37.219	51.016	37,1	116.295	182.017	56,5
Angli	21.061	27.725	31,6	52.250	70.626	35,2
Mali i zi	18.109	21.956	21,2	185.854	194.039	4,4
Poloni	17.535	31.202	77,9	34.304	58.710	71,1
SHBA	16.313	21.958	34,6	43.865	57.843	31,9
Gjermani	15.001	21.809	45,4	40.288	62.889	56,1
Zvicër	12.337	18.784	52,3	23.855	33.349	39,8
Të tjera	160.443	231.630	44,4	376.473	510.416	35,6
Gjithsej	864.718	864.023	-0,1	2.465.413	2.623.317	6,4

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Korrik-16	Korrik-17	Janar-Korrik 16	Janar-Korrik 17
Hyrje Shtetas të Huaj	864.718	864.023	2.465.413	2.623.317
I. Personale	859.772	856.707	2.433.592	2.583.887
1. Pushime	544.575	487.275	774.316	1.049.242
2. Vizitë në miq e të afërm	3.085	2.605	10.665	7.897
3. Vizitë ditore	93.297	105.345	314.483	144.562
4. Trajtim shëndetësor	48	10	433	269
5. Qëllime fetare	76	126	588	427
6. Vizitorë të tjerë	192.760	230.427	1.236.235	1.273.864
7. Udhëtarë tranzit	25.931	30.919	96.872	107.626
II. Biznes dhe profesionale	4.946	7.316	31.821	39.430

Tab.4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Korrik - 16	128.653	122.485	1.091.198	93.753	65.788	1.122.459
Korrik - 17	163.863	153.871	1.061.568	127.260	88.269	1.146.962
Ndryshimi vjetor (%)	27,4	25,6	-2,7	35,7	34,2	2,2
Janar-Korrik 2016	594.648	315.651	4.014.427	542.593	282.419	4.239.774
Janar-Korrik 2017	726.065	383.412	4.089.668	692.174	349.248	4.322.496
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	22,1	21,5	1,9	27,6	23,7	2,0

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>